



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2023-014**

**Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës -** Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokati V.H., kundër vendimit të nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, më 20.06.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e avokatit V.H., paraqitur kundër vendimit të Nënkyetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicë, AD/GJTHPR/05/23 datë 25.05.2023.

**A r s y e t i m**

Në këtë Gjykatë me 15 qershor 2023 është pranuar ankesa e avokatit V.H., e paraqitur kundër vendimit AD/GJTHPR/05/23 datë 25.05.2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-respektivisht nënkryetarit të kësaj gjykate –B.V., me të cilin është refuzuar ankesa e avokatit të lartcekur për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit I.G.. Ankesa është ushtruar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kjo Gjykatë të aprovoj ankesën, kurse vendimi i lartcekur të ndryshohet ashtu që ndaj gjyqtarit I.G., të iniciohet procedura disiplinore, të cilën ankesë ia ka drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ushtruesja e Detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat i janë bashkangjitur ankesës, vlerëson se:

-Ankesa nuk është e lejuar.

Nga shkresat e çështjes del se avokati V.H., ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit I.G., - gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtri-Divizioni Civil dhe kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Nënkyetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit Për Përgjegjësinë

Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duke vendosur përkitazi me ankesën me vendimin AD/GJTHPR/09/23 datë 5.06.2023 e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Ndaj vendimit të lartcekur në këtë gjykatë ka ushtruar ankesë avokati V.H., me propozim që ankesa të aprovohet, kurse vendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që ndaj gjyqtarit I.G., të iniciohet procedura disiplinore.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes vlerësoj se ankesa e avokatit në rastin konkret nuk është e lejuar për këto arsye:

Sipas Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji - secili person fizik dhe juridik mund të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent. Po ashtu, sipas këtij ligji - nenit 9 par.6 të tij autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 par.2 ( e fillon procedurën disiplinore kur vlerëson se ka bazë), përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Kurse, edhe sipas Rregullores (05/2019) nenit 7 par.1 të kësaj Rregulloreje pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent ankesën mund ta hudh, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon ankesën për inicim të procedurës disiplinore ankuesi mund të ushtroj në ankesë ndaj këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Nënkyetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me shkresat e bashkëngjitura vlerësoj se ankesa është e palejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Nënkyetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

GJS-2023-014

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj, duke vendosur sipas detyrës zyrtare konfirm nenit 21 të Rregullores (05/2019) për procedurën disiplinore të gjyqtarëve më 23.06.2023, mori këtë aktvendim.

**A K T V E N D I M**

Përmirësohet aktvendimi i kësaj Gjykate GJS-2023-014 datë 20.06.2023, ashtu që në dispozitiv të aktvendimit, hyrje të arsytimit -rreshti i dytë, dhe faqja e dytë-pasuesi i parë rreshti i fundit, në vend të numrit AD//GJTHPR/05/23 duhet të jetë AD/GJTHM/05/23, po ashtu në faqen e dytë në pasusin e fundit fjalia e dytë në vend të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duhet të jetë Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

**A r s y e t i m**

Pas ekspeditimit të aktvendimit të kësaj gjykate me numër GJS-2023-014 të datës 20.06.2023, kjo gjykatë ka vërejtur lëshime të natyrës teknike prandaj ka marr iniciativë për përmirësimin e tij.

Kështu, pas rishikimit të shkresave dhe përmbajtjes së aktvendimit, është vërejtur se me rastin e përpilimit të aktvendimit është bërë lëshim teknik, në faqen e parë në dispozitiv të aktvendimit, hyrje të arsytimit dhe në faqen dytë - pasusi i parë rreshti i fundit, ku në vend të numrit AD/GJTHP/05/23 duhet të jetë AD/GJTHM/05/23, e po ashtu në faqen e dytë - fjalia e dytë, në vend të Gjykatës Themelore në Prishtinë duhet të jetë Gjykata Themelore në Mitrovicë.

Për arsytet e lartcekura, e në pajtim me dispozitën e nenit 21 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Mejreme Memaj  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Palës ankuese,
3. Arkivit të Gjykatës Supreme.